REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Raporti vjetor i punës së Këshillit Bashkiak Has viti 2025.

Në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në zbatim të parimeve të transparencës, llogaridhënies dhe informimit publik, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Has harton dhe paraqet raportin vjetor të veprimtarisë për periudhën janar–dhjetor 2025. Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ka ushtruar funksionet e tij në përputhje me kompetencat ligjore, duke u fokusuar në miratimin e akteve, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe në adresimin e çështjeve me interes për komunitetin e Bashkisë Has.

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Këshillit Bashkiak është karakterizuar nga zhvillimi i mbledhjeve të rregullta, shqyrtimi i projektvendimeve të paraqitura nga administrata, si dhe trajtimi i kërkesave dhe ankesave të ardhura nga qytetarët dhe institucionet e ndryshme. Në këtë kuadër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar rritjes së transparencës në vendimmarrje dhe përfshirjes së publikut në proceset konsultative. Ky raport paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe analitike veprimtarinë e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Has për vitin 2025, duke evidentuar numrin e mbledhjeve të zhvilluara, vendimet e marra, kërkesat e trajtuara, si dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera publike.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Këshilli Bashkiak Has ka realizuar 12 mbledhje radhe dhe 2 mbledhje jashtë radhe. Në këto mbledhje janë marrë gjithsej 121 vendime.

Gjatë vitit 2025, pjesëmarrja e këshilltarëve në mbledhjet e këshillit Bashkiak të Bashkisë Has ka qenë në nivele të kënaqshme. Pjesa më e madhe e këshilltarëve kanë marrë pjesë rregullisht në mbledhje, duke kontribuar në procesin vendimmarrës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Kryesia e Këshillit Bashkiak, si strukturë drejtuese dhe organizative e punës së Këshillit ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionimit normal dhe efikas të tij gjatë vitit. Kryesia është mbledhur duke shqyrtuar çështje që lidhen me përgatitjen e rendit të ditës, koordinimin e punës me administratën bashkiake, si dhe trajtimin paraprak të materialeve që i nënshtrohen diskutimit në mbledhjet e Këshillit.

Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve në total në Këshillin Bashkisë Has për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë regjistruar 62 kërkesa/ankesa të cilat janë trajtuar në mbledhjen e komisionit përkatës, ndërsa pjesa tjetër është trajtuar drejtpërdrejt nga Sekretari i Këshillit në bashkëpunim me drejtoritë.

Gjatë vitit 2025, komisionet e përhershme janë mbledhur për të shqyrtuar projekt- vendime, materiale informuese dhe çështje të ndryshme me interes për komunitetin e Bashkisë Has.

Gjatë 2025 të gjitha mbledhjet janë zhvilluar në sallën e Këshillit Bashkiak. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë transmetuar live në faqen e Facebook- të Këshilit Bashkiak, çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Marrëdhëniet me Prefektin e Qarkut Këshilli Bashkiak Has, në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ka dërguar pranë institucionit të prefektit për verifikim ligjshmërie të gjitha aktet me karakter normativ. Asnjë akt nuk është kthyer për rishqyrtim. Gjithashtu, përfaqësues të institucionit të prefektit kanë kryer kontrollin e verifikimit të ligjshmërisë në vend, sipas parashikimeve ligjore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Gjatë 2025 janë organizuar 14 Konsultime Publike:

1.Për planin e masave për ndotjen akustike.

2. Për rishikimin e buxhetit të Bashkisë Has për vitin 2025 & rishikim i VKB Nr.135 datë 23. 12.2024 Sistemim i Taksave dhe Tarifave Vendore (Taksa Ndërtesës).

3. Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Has.

4. Për Planin e Integrimit Gjinor, Bashkia Has.

5. Për Planin e Arsimit Parauniversitar.

6. Për miratimin e Tavaneve Përfundimtare PBA 2026- 2028.

7. Për Planin e Veprimit për Diasporën dhe Emigrimin.

8. Për Planin e Integritetit të Bashkisë Has.

9. Plani i Menaxhimit të Pyjeve të Bashkisë Has (i përditësuar).

10. Për Planin Strategjik i Zhvillimit Vendor 2026-2030.

11. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026.

12. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Gjinaj.

13. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Fajza.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

14. Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Has 2026, PBA 2026-2028, Taksat dhe Tarifat vendore 2026, Njësia Administrative Golaj.

Për të ofruar një pasqyrë sa më të detajuar dhe kronologjike të veprimtarisë së Këshillit Bashkiak gjatë vitit, raporti vijon me një analizë të strukturuar mujore duke filluar nga muaji janar deri në muajin dhjetor. Në vijim për çdo muaj paraqiten mbledhjet e zhvilluara, çështjet e trajtuara në rendin e ditës dhe vendimet e marra.

JANAR 2025.

Në muajin Janar është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 27/01/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Dhjetor të datës 23/12/2024. Është miratuar projekt vendimi "Shtesë në transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025, sipas aktit normativ Nr.5 datë 19/12/2024. Janë miratuar projekt-vendime për bursat profesionale për vitin 2024-2025, gjithashtu dhe projekt-vendim bursat për nxënësit e akomoduar në konviktin "Kosova" Krumë 2024-2025. Është miratuar projekt vendimi në lidhje me programin plani i strehimit social. Janë miratuar listat e familjeve për strehimin social. Janë miratuar disa projekt vendime në lidhje me sektorin e Arsimit dhe Kulturës, siç janë: 1-Fondi për blerje të disa veglave muzikore dhe veshje popullore për Pallatin e Kulturës Has, 2-Miratimi i aktiviteteve social-kulturore që parashikohen të mbahen gjatë vitit 2025 në Bashkinë Has. Është miratuar plani i përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Has. Është miratuar Këshilli Vendor i Sigurisë Publike në Bashkinë Has dhe miratimin e rregullores për oraganizmin dhe funksionimin e tij. Janë miratuar kriteret e 6% për vitin 2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Dhjetor 2024 gjithsej 183 familje me një fond 909,603 lekë. Janë trajtuar disa kërkesa të qytetarëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

SHKURT 2025.

Në muajin Shkurt është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 24/02/2925. Është miratuar proçesverbali i muajit Janar të datës 27/01/2025. Është miratuar projekt vendimi raporti i monitorimit të Buxhetit për vitin 2024. Është miratuar projekt vendimi një shtesë në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025(Akt Trashëgimia 2024 në Buxhetin 2025). Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Janar 2025 gjithsej gjithsej 184 familje, me një fond total prej 915,584 lekë. Është miratuar projekt vendimi i emergjencave civile për familjen e Ilirjan Abedin Gecës që ka banesën e dëmtuar. Janë miratuar një listë projektesh:

1.Ndërtim KUZ,Lagje Brati,fshati Golaj,vlerë me tvsh 1,199,054 lekë.

2.Ndërtim KUZ,Lagje Brasha,fshati Helshan,vlerë me tvsh 550,570 lekë.

3.Ndërtim KUZ,Lagje Qela,fshati Helshan,vlerë me tvsh 1,173,987 lekë.

4.Ndërtim KUZ,Lagje Dautaj (Keqan), fshati Golaj,vlerë me tvsh 1,199,380 lekë.

Është miratuar kërkesa nga EKB Kukës, për qytetaren zj.Shiqirije Mica. Është trajtuar një kërkesë e qytetarit z.Meshi për një konflikt rruge "Rruga Veshtre.

MARS 2025.

Në muajin Mars është mbajtur mledhja e rradhës me datë 26/03/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Shkurt të datës 24/02/2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Shkurt 2025 gjithsej 185 familje, me një fond total prej 910,671 lekë. Është miratuar projekt vendimi i emergjencave civile për familjen e Mus Rexh Gjoni që ka banesën e dëmtuar. Është miratuar projekt vendimi Rishpërndarje dhe sistemim në Buxhetin e Bashkisë Has për një qytetar

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

për ndihmë financiare z.Agron Malaj. Është miratuar raporti i perfomancës së Këshillit Bashkiak Has për vitin 2024. Është miratuar proçesverbali i ndarjes së kufijve Pusi Thatë -Gjinaj. Janë trajtuar disa kërkesa të qytetarëve.

PRILL 2025.

Në muajin Prill është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 24/04/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Mars të datës 26/03/2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Mars 2025 gjithsej 182 familje, me një fond total prej 891,148 lekë.

MAJ 2025.

Në muajin Maj është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 26/05/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Prill të datës 24/04/2025. Është miratur projekt vendimi ndihmë financiare për 2 qytetarë:1. Ramiz Jupa 2. Everest Geca. Është miratur projekt vendimi rishqyrtim mbi VKB nr.137 datë 23.12.2024 "Për Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Prill 2025 gjithsej 180 familje, me një fond total prej 881, 286 lekë. Është miratuar projekt vendimi i emergjencave civile për 4 familje: 1. Raze Haxhi Metalia, 2. Saimir Din Çerkezi, 3. Zoje Binak Aga, 4. Shpend Sadik Aliaj. Është miratuar projekt vendimi bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë. Është miratuar

projekti për investim "Riparim i rrugës fshati Qarr" Vlera e projektit: 87,567,412.26 lekë me TVSH.

QERSHOR 2025.

Në muajin Qershor është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 23/06/2025.Është miratuar proçesverbali i muajit Maj të datës 26/05/2025. Është miratuar projekt vendimi raportimi i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë 2025. Është miratuar projekt-vendimi ndryshim në

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

strukturën organizative të Bashkisë Has të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhër nr.12, datë 14.01.2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Maj 2025 gjithsej 181 familje me një fond total prej 869,050 lekë. Është miratuar projekt vendimi i emergjencave civile për 1 familje 1. Agron Qerim Dautaj. Është miratuar projekt vendimi bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë. Është miratuar projekt vendimi Marrëveshje e bashkëpunimit në zbatim të projektit "Tregues i komunitetit për investime në vlerë dhe kapacitete inovacioni" në kuadër të programit "IPA ADRION" financuar nga Bashkimi Europian. Janë miratuar ndihma financiare për qytetarët:

1.Teuta Peka 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

2.Shkurte Mulaj 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

3.Qamil Kamberi 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

4.Agim Daçi 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

5.Arben Brati 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

6.Shaqir Kraja 100,000-Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Është miratuar plani i masave për Ndotjen Akustike. Është trajtuar kërkesa e Z. Ramiz Toblit në lidhje me një konflikt rruge në lagjen Tobel.

QERSHOR/1/2025: Në muajin Qershor është mbajtur mbledhje jashtë rradhe me datë 27/06/2025. Në këtë mbledhje u shqyrtuan konfliktet e ardhura nga Kryepleqësitë e fshatrave të Bashkisë Has:

1-Konflikti lagjia Bardhosh,Njësia Administrative Golaj.

2-Konflikti lagjis Qunaj,Njësia Administrative Golaj.

3-Konflikti lagjia Selaj,Njësia Administrative Gjinaj. Këshilli vendosi të miratojë vendimin përfundimtar të kryepleqësisë që do të sillet nga kryepleqësia e fshatit brenda dates 10 korrik për qështjen e rrugës në Lagjen Qunaj, Letaj.Këshilli vendosi të miratojë vendimin e sjellë nga kryepleqësia e fshatit Gjinaj për konfliktin në Lagjen Selaj. Këshilli vendosi të miratojë vendimin e Kryepleqësisë së fshatit Tobël si dhe relacionin e sjellë nga administratori i njësisë Fajza,ku vuri në dijeni që prona territori kullotë me ngastër 110/b që banorët pretendonin që u takon atyre, është pronë e Bashkisë Has,dhe nuk ka të drejtë askush të ndërhyjë.

KORRIK 2025:

Në muajin Korrik është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 21/07/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Qershor të datës 23/06/2025. Është miratuar projekt- vendimi rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Has për vitin 2025. Është miratuar projekt- vendimi për nxjerrjen jashtë

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

përdorimit të disa pajisjeve inventar ekonomik dhe imët për Bashkinë Has, Njësitë Administrative Qendër, Fajza, Golaj dhe Gjinaj për vitin 2024. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Qershor 2025 gjithsej 180 familje me një fond total prej 860,814 lekë. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të integruar të Mbetjeve, Bashkia Has. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e pjesëmarrjes së Aleancës Gjinore Has në krijimin e koalicionit Gjinor Rajonal.

GUSHT 2025:

Në muajin Gusht është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 29/08/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Korrik të datës 21/07/2025. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e tavaneve përfundimtare të PBA 2026- 2028. (Faza e II) Është miratuar projekt- vendimi rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Has në transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025. Është miratuar ndihmë financiare për qytetarin:

Halit Lushi 100,000- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Korrik 2025 gjithsej 181 familje me një fond total prej 846,260 lekë. Është miratuar projekt vendimi bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë. Janë miratuar projekt- vendimet miratimi i Planit të Integrimit Gjinor, miratimi i Planit të Arsimit Parauniversitar dhe miratimi i Planit të Veprimit për Diasporën dhe Emigrimin. Është miratuar marrëveshja për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes

SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë (TALGA). Tek pika kërkesa të ndryshme është miratuar ndërtimi i Muzeut.

SHTATOR/1/2025:

Në muajin Shtator është mbajtur mbledhje jashtë rradhe me datë 09/09/2025. Në këtë mbledhje u miratuan: Plani i Menaxhimit të Pyjeve (i përditësuar) të Bashkisë Has për periudhën 2025- 2030, Plani i Integritetit të Bashkisë Has për periudhën 2025- 2027, Plani Social të Bashkisë Has (i rishikuar) për periudhën 2025- 2028.

SHTATOR 2025:

Në muajin Shtator është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 29/09/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Gusht të datës 29/08/2025. Është miratuar projekt- vendimi rishpërndarje në Buxhetin e Bashkisë Has në transfertën e pakushtëzuar për vitin 2025. Është miratuar ndihmë financiare për qytetarët:

Remzie Qela 50,000- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

Agim Daçi 50,000- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

Është miratuar dhënia e ndihmës financiare për rënie zjarri në banesën e tij për qytetarin:

Ilir Ibrahim Mazrreku 183, 199 lekë: Preventiv ndërtimi 50% 40,899 lekë dhe Preventi orendrive 100% 142, 300 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Gusht 2025 gjithsej 182 familje me një fond total prej 854,535 lekë.

TETOR 2025:

Në muajin Tetor është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 27/10/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Shtator të datës 29/09/2025. Është miratuar projekt- vendimi për monitorimin për buxhetin e 4- mujorit të dytë 2025. Është miratuar projekt- vendimi për rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has 2025. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Shtator 2025 gjithsej 189 familje me një fond total prej 891,187 lekë. Është miratuar Plani Strategjik i Zhvillimit Vendor të Bashkisë Has për periudhën 2026- 2030. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e hartës së linjave sipas largësive për transportin e punonjësve arsimorë që punonjnë dhe të nxënësve që mësojnë, udhëtojnë mbi 2 km (të ndyshuar) në institucionet arsiomore parauniversitare. Është miratuar projekt vendimi bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë. Është trajtuar kërkesa e banorëve të fshatit Kishaj për zgjedhjen e Kryetarit të fshatit Kishaj.

NËNTOR 2025

Në muajin Nëntor është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 25/11/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Tetor të datës 27/10/2025. Është miratuar projekt vendimi për emërtimin e Urës së Re e ndërtuar mbi përroin e Vlahnës, e cila lidh lagjen "Pukaj" me fshatin Zahrishtë, Ura "Adem Imer Laçi- 1980". Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e kalendarit të eventeve dhe datave historike të Bashkisë Has dhe mbulimin financiar të shpenzimeve. Është miratuar projekt- vendimi për fondin për transport fëmijës Ervin Asllan Dauti dhe shoqëruesit të tij (nënës), për lëvizjen në aksin rrugor Krumë- Kukës- Krumë, për 4 ditë të javës, sipas orarit të përcaktuar

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

nga shkolla (Qendra e Shërbimeve me bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara) me një fond prej 96, 000 lekë. Është miratuar projekt- vendimi për rishpërndarjen e fondit për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi me vlerë 2, 046, 000 lekë. Është miratuar projekt-vendimi për dhënien në përdorim të territorit me qëllim studimi për ndërtimin e parkut energjitik me erë nga shoqëria"EU GREEN ENERGY" dhe "SOFIR ALBANIA" sh.p.k. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Tetor 2025 gjithsej 188 familje me një fond total prej 891,545 lekë. Janë miratuar ndihma financiare për qytetarët:

Eduart Mal Gjoni 235, 768 lekë - Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Isa Mus Geca 154, 589 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Luan Ramiz Thaçi 149, 785 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Ukë Musli Rada 199, 721.5 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Petrit Deli Harhulla 226, 495 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e zonave me prioritet zhvillimi: zona për zhvillimin e agroturizmit, zona për zhvillim turistik, zona për mbjelljen e bimëve vendase, zona e vreshtave dhe zona e pemtoreve. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e zonave me prioritet, qëllim tërheqjen e investimeve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik apo turistik në zonat me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore si: fshati Cahan, Ahishta e Liqenit të Kuq, Kukrora e Krumës, Nj.Adm Gjinaj dhe Nikoliq- lagjia Ngjeç.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

DHJETOR 2025:

Në muajin Dhjetor është mbajtur mbledhja e rradhës me datë 24/12/2025. Është miratuar proçesverbali i muajit Nëntor të datës 25/11/2025. Është miratuar sistemi i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2026. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe Njësive Administrative dhe klasifikimi i pagave të administratës dhe punonjësve të tjerë për vitin 2026. Është miratuar projekt- vendimi për miratimin e klasifikimit të pagave për vitin 2026 në Bashkinë Has. Është miratuar projekt-vendimi për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Has për vitin 2026 dhe PBA përfundimtare 2026-2028. Janë miratuar bursat për nxënësit konviktor viti I Gjimnazi "Skenderbeu" Krumë për vitin 2025-2026, bursat për nxënësit konviktor viti II, III Gjimnazi "Skenderbeu" Krumë për vitin 2025-2026 dhe bursat për shkollat profesionale për vitin 2025-2026. Është miratuar plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Has për vitin 2026. Kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi 6% për muajin Nëntor 2025 gjithsej 189 familje me një fond total prej 887,979 lekë. Është miratuar Raporti i Performancës së Bashkisë Has për vitin 2024. Janë miratuar ndihma financiare për qytetarët:

Milaim Rexhep Sefolli 207, 932.7 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Selim Bali Çela 260,111 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Astrit Sali Geca 212, 913 lekë- Mbështetje financiare për fatkeqësi natyrore.

Është miratuar Plani i Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë për vitin 2025-2030.

Është miratuar fondi ndihmë financiare për qytetarët:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

1. Skënder Begu 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

2. Fatbardh Merturi 50, 000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

3. Besnik Goça 200, 000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

4. Emrije Dida 200, 000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

5. Shkurte Qema 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

6. Valdete Mazrreku 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

7. Sanije Lala 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

8. Luljeta Muhadri 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

9. Albana Lushi 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

10. Bukurie Muneka 50,000 lekë- Mbështetje financiare për kushte të vështira familjare, shëndetësore dhe ekonomike.

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HAS

KËSHILLI

Është miratuar projekt- vendimi për miratimin Rregullore e Brendshme për Caktimin e Strukturave Përgjegjëse dhe Procedurave për Matjen e Raportimin e Përformancës në Bashki.

Ky raport vjetor përbën një instrument të rëndësishëm për orientimin e punës në të ardhmen me synimin për të rritur cilësinë e vendimmarrjes dhe për të forcuar besimin e qytetarëve ndaj instuticioneve vendore.

Punë të mbarë për vitin 2026 dhe faleminderit për kontributin e secilit prej jush!

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

NEZIR LUSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al